Zoti Ministër,

Zonja Drejtoreshë e Shkollës së Magjistraturës,

Zoti Shef i projektit evropian për konsolidimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, Euralius,

Zotërinj Ambasadorë,

Zonja dhe Zotërinj,

Jam shumë e lumtur që ndodhem midis jush sot për të hapur këtë konferencë rajonale mbi përzgjedhjen, trajnimin dhe emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të vendeve të Evropës Juglindore.

Kjo konferencë mbahet në kuadrin e ciklit të konferencave mbi Drejtësinë dhe të Drejtat e Njeriut në vendet e Evropës Juglindore, të organizuara në vende të ndryshme nga Ministria Franceze e Punëve të Jashtme.

Shqipëria është zgjedhur këtë vit me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë si dhe të 15-vjetorit të Shkollës shqiptare të Magjistraturës, e lidhur falë një partneriteti me Shkollën Kombëtare të Magjistraturës franceze. Ne jemi tepër të nderuar që Presidenti i Republikës, Shkëlqesia e tij, Z. Bujar Nishani, ka pranuar t'i japë mbështetjen e tij kësaj konference.

Konferenca do të trajtojë përzgjedhjen, trajnimin dhe emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të vendeve të Evropës Juglindore.

Procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e magjitratëve, trajnimin, kufizimin e ndikimit të pushtetit politik në procesin e emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përcaktimi i kritereve objektivë të karrierës, të rregullave të transferimeve, të luftës kundër korrupsionit në sistemin gjyqësor, përzgjedhja dhe vlerësimi i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të gjitha këto janë thelbësore.

Këto çështje janë shtyllat e transparencës, të efikasitetit, të përgjegjshmërisë dhe të pavarësisë për çdo sistemi drejtësie.

Ato janë gjithashtu thelbësore që njerëzit të kenë besim në sistemin gjyqësor, në institucionet gjyqësore. Që popullsia, dhe bashkë me të, të gjitha institucionet e vendit, të respektojnë autoritetin e çështjes së gjykuar, një element parësor i shtetit të së drejtës.

Të gjitha këto çështje janë shumë të rëndësishme për të gjitha vendet

pjesëmarrëse dhe kjo është arsyeja përse ju keni ardhur të shumtë në këtë konferencë. Cilësitë tuaja të shquara prej profesionistësh dhe prej praktikantësh do të kontribuojnë për shkëmbime pikëpamjesh dhe përvojash ku të gjithë ju mund të përfitoni.

Ju jeni të mirëpritur ngrohtësisht nga autoritetet shqiptare, Zoti Ministër i Drejtësisë, Zonja Drejtoreshë e Shkollës së Magjistraturës, me të cilët Ambasada e Francës ka përgatitur këtë konferencë. Nga ana ime, ju uroj mirëseardhjen në Tiranë dhe punë të mbarë.